73. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 5 dhe 10 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Desla” sh.p.k.
74. Leje Ndërtimi për objektin: “Resort turistik dhe rezidencial “Terra-Mare” me objekte hotelerie 1-5 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë dhe objekte banimi 1-5 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “T&M Construction” sh.p.k.
75. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 9 dhe 11 kate mbi tokë, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Abedin Rexha”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “ADMC Internacional” sh.p.k.
76. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë polifunksionale, shërbime, turizëm mjekësor dhe hoteleri”, me vendndodhje në Bashkinë Lushnje, me subjekt zhvillues shoqërinë “UPTC” sh.p.k.
77. Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks me njësi hotelerie me 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë dhe vila akomoduese me 1 dhe 2 kate mbi tokë, në funksion të hotelit, me vendndodhje në Bogë, Bashkia Malësi e Madhe”, me subjekt zhvillues shoqërinë “F & D Capital” sh.p.k.
78. Leje Ndërtimi për objektin: “Magazinë industriale 1 dhe 3 kate”, me vendndodhje në Rrugën Prush, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ibitex” sh.p.k.
79. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt industrial ushqimor i përpunimit të qumështit”, me vendndodhje në njësinë administrative baldushk, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Lara-Cheese” sh.p.k.
80. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt magazinimi me 3 kate mbi tokë dhe 1 - 2 kate nëntokë me mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Trust Distribution” sh.p.k dhe shoqërinë “Joena 2” sh.p.k.

- 81. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt magazinimi me 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë me mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Joena 2” sh.p.k dhe shoqërinë “Trust Distribution” sh.p.k.**
- 82. Leje për miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe pemtarisë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Naim Tragaj Group” sh.p.k.**
- 83. Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtim magazine bujqësore 1 kat”, me vendndodhje në Bashkinë Mallakastër, me zhvillues Z.Amarildo Asllanaj.**
- 84. Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks industrial dhe administrativ - Kapanone 1 kat dhe zyra 3 kat mbi tokë”, me vendndodhje në Bashkinë Vorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Birra Peja Albania” sh.p.k.**
- 85. Leje Ndërtimi për objektin: “Godina industriale me 2 kate mbi tokë dhe me një pjesë administratë”, me vendndodhje në Fortuzaj, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Z. Mariklen Elmazaj.**
- 86. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë shërbimi 1 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, , me subjekt zhvillues shoqërinë “Spar Albania” sh.p.k.**
- 87. Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW dhe veprave ndihmëse”, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Gemtech Albania” sh.p.k.**
- 88. Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Ndërtimi i linjës së re me një qark 220 Kv për lidhjen e parkut fotovoltaike “EZ-5 Solar Park” me rrjetin energjitik”, me subjekt zhvillues shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k.**
- 89. Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 MW, dhe veprave ndihmëse”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Assa Energy Solution” sh.p.k.**
- 90. Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe Infrastruktura e Lidhjes me Rrjetin Elektrik, Parku Fotovoltaike BLUE 3 me fuqi 36.16MW, me subjekt zhvillues shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k.**
- 91. Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Ndërtimi i Linjës Elektrike 110 kV për Lidhjen e Impiantit Fotovoltaike “Gjorica Solar Park” në NST 110/10kV Shupenze dhe Traktit Hyrëse”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Infotelecom-Albsolar” sh.p.k.**
- 92. Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtimi i impiantit gjenerues “Spitalla Solar park”, me kapacitet të instaluar 100 kw, Nënstacionit 110/30 kv dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k.**

93. **Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Linjë elektrike për lidhjen në rrjet të impiantit gjenerues të energjisë elektrike e Impiantit Fotovoltaik “Spitalla Solar”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k.**
94. **Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Linja 35 kV me një qark Parku fotovoltaik “Power Energy” – Nënstacioni “Sunny Side Solar Park”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Power Energy” sh.p.k.**
95. **Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Linjë elektrike për lidhjen e rrjetit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me fuqi 29.13 MW”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Glow Solar” sh.p.k.**
96. **Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Linjë elektrike për lidhjen e rrjetit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me fuqi 29.13 MW”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Voltz Solar” sh.p.k.**
97. **Për konfiskim për interes publik për objektin e konstatuar pa leje ndërtimi “Objekt 3 kate me konstruksion betonarme me sipërfaqe të gjurmës 320 m² dhe me sipërfaqe totale rreth 480 m²”, nga subjekti Julian Esat Zeka, me vendndodhje në Rrugën “Hiqmet Buzi”, Bashkia Tiranë.**
98. **Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 9 – 10 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën: “Sul Elezi”, Bashkia Kukës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ramallari” sh.p.k.**

Njoftim anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit mbi:

- **mbi saktësime në *disa Vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit sipas listës bashkëlidhur.***
- **kërkesat për kontroll përputhshmërie të shqyrtuara nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për periudhën 23.10.2025 deri më tani, sipas Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar si dhe Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015**

Me respekt,
Adelajda ROKA

S e k r e t a r
Këshilli Kombëtar i Territorit

Annex F03-A7

National Council of Territory and Water Agenda

29 April 2026 - Item 5

Document type: Official meeting agenda

Infrastructure building-permit proposal concerning
fencing and preparatory access-road works.

The signed Decision No. 5 and its annexes were not
located in the material reviewed.

Original Albanian-language document follows



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT
SEKRETARIATI**

RENDI I DITËS

Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit

E Mërkurë, datë 29.04.2026, ora 08⁰⁰ – 10⁰⁰

1. **Leje Ndërtimi për objektin: “Ndërtimi i segmentit të ri të linjës 110 kV”, me vendndodhje pranë Nënstacionit Akerni, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.**
2. **Leje për miratimin e ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Parku Natyror Liqeni i Ulzës”, me vendndodhje në Bashkinë Mat, me zhvillues Ministrinë e Mjedisit.**
3. **Leje për miratimin e ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Përshtatjen e ambjenteve të brendshme të objektit “Inkubatori i Biznesit” në zyra për strukturën e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ndërtimi i Urës lidhëse midis dy objekteve eksistuese”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, me zhvillues Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).**
4. **Leje Ndërtimi për objektin: “Rikonstruksion dhe shtesë kati për objektin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.**
5. **Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Për kryerjen e punimeve të rrethimit dhe të punimeve përgatitore në funksion të ndërtimit të rrugëve të aksesit brënda prone”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Zvërnec South Adriatic Development” sh.p.k.**
6. **Leje Zhvillimi për objektin: “Vila me konstruksion druri”, me vendndodhje në Velipojë, Bashkia Shkodër, me zhvillues Z.Andrea Gjini.**
7. **Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë shërbimi akomoduese dhe hoteleri me 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate”, me vendndodhje në Peqinaj, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Dalona” sh.p.k.**
8. **Leje Zhvillimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 4 dhe 5 kate, me 1 kat parkim nëntokë”, me vendndodhje Mali Shëngjin, Bashkia Lezhë, me subjekt zhvillues “DAB 20” sh.p.k.**

9. **Leje Zhvillimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbime me 8 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Qerret, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Prior Construction” sh.p.k.**
10. **Leje Ndërtimi për objektin: Godinë shërbimi hotelier 1, 2, 3, 4, 5 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje Bashkia Sarandë, me zhvillues Z.Fatmir Balla.**
11. **Leje Zhvillimi për objektin: “Objekt banimi 3 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje Bashkia Himarë, me zhvillues Znj.Valbona Tafilaj dhe Z.Betim Tafilaj.**
12. **Leje Zhvillimi për objektin: “Vilë individuale 1 dhe 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Daed” sh.p.k.**
13. **Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë banimi, shërbime dhe funksione të përziera me 16 kate mbi tokë dhe 4 kat nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Margarita Tutulani”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Paga Village” sh.p.k.**
14. **Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues Znj.Mirela Ibrahimimi dhe Z.Arlind Ibrahimimi.**
15. **Leje Zhvillimi për objektin: “Objekti hotelieri dhe shërbime 4 kate”, me vendndodhje në Potam, Bashkia Himarë me zhvillues Z.Leonard Rondo.**
16. **Leje Ndërtimi për objektin: “Lugano Gardens” Objekte banimi 1, 2 dhe 3 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Lugano” sh.p.k.**
17. **Leje Zhvillimi për objektin: “Hotel me 6 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me zhvillues Z.Elvis Shyrbi dhe Znj.Vjola Serjani.**
18. **Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë 1-7 kate, me 2 kate nëntokë, me funksion hotelieri” me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hanxhari 1” sh.p.k.**
19. **Leje Zhvillimi për objektin: “Objekt banimi 4 kat dhe 1 kat nëntokë parkim”, me vendndodhje Bashkia Sarandë, me zhvillues z.Agron Mustafa Murtaç.**
20. **Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks turistik 1-2 kate, me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “5D Konstruksion” sh.p.k.**
21. **Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks hotelerie 1, 2, 3 dhe 4 kat, me 1 kat nëntokë, me pishinë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në shëtitoren Borsh, bashkia Himarë, me zhvillues Z. Lulëzim Masha.**
22. **Leje Zhvillimi për objektin: “Ticino Residence”, me vendndodhje në Mëzez, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “KiiZ” sh.p.k.**

- 23. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt hoteleri dhe shërbime 4 dhe 5 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë”, me vendndodhje në bashkinë Rrogozhinë, me subjekt zhvillues Znj. Brikena Uka dhe Z. Rifat Uka.**
- 24. Leje Zhvillimi për objektin: “Hotel 4 kat me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Ksamil, bashkia Sarandë, me zhvillues Z. Artur Emini.**
- 25. Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë hotelerie 1-6-11 kate dhe banim dhe shërbim 1-7 kat, me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Qerret, bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tetragon Construction” sh.p.k.**
- 26. Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë hotelerie 1 kat, 2 kat, 3 kat dhe 4 kat mbitokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues Z.Aristidh Goro.**
- 27. Leje Zhvillimi për objektin: “Hotel & apart-hotel, 2 dhe 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Klint 2021” sh.p.k.**
- 28. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë shërbimi dhe banimi në funksion të hotelierisë, 7 kate me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Riviera Investment” sh.p.k.**
- 29. Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks rezidencial banimi 1,2,4,5,6 dhe 7 kate mbitokë + 1, 2, 3 dhe 4 kate parkimi nëntokë, Victoria City”, me vendndodhje në Shkozë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arkonstudio” sh.p.k.**
- 30. Leje Zhvillimi për objektin: “Godinë multifunksionale, shërbim, hoteleri, 4 kate dhe 1 kate nëntokë me taracë të shfrytëzueshme”, me vendndodhje në Rrugën “Teki Hadërri”, Bashkia Sarandë, me zhvillues Znj. Anabela Xhuveli.**
- 31. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë turistike 7 kate dhe 8 kate, dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje Bashkia Sarandë, me zhvillues Z. Pandeli Dhima.**
- 32. Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë turistike hotelerie 5 kate + 1 kat nëntokë, pishinë dhe rrethim i pronës” me vendndodhje në Draç, Bashkia Durrës, me zhvillues Znj. Blerind Biçaku, Znj. Mirgena Biçaku, Z. Rogert Zylfo dhe Znj. Nevila Bande.**
- 33. Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks me vila individuale 2 kate, me 1 kat nëntokë me pishina, në Rrugën “Andrea Topia”, Farkë, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Star Investment Group” sh.p.k.**
- 34. Leje Zhvillimi për objektin: “Godinë shërbimi hotel dhe apart-hotel, 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Radhimë - Bashkia Vlore, me zhvillues Z. Perlat Hasanbashaj.**
- 35. Leje Ndërtimi për objektin: “Kompleks Turizëm Rural”, me vendndodhje në Bashkinë Fushë Arrëz, me subjekt zhvillues shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.p.k.**

- 36. Leje Ndërtimi për objektin: “Vila familjare 2 dhe 3 kate me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Voskopojë, Bashkia Korçë, me subjekt zhvillues shoqërinë “MA1” sh.p.k.**
- 37. Leje Ndërtimi për objektin: “Naya”, Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 7-17 kate dhe 1-2 kate parkimi nëntokë, me vendndodhje në Rrugën “Gjon Simoni”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kontakt” sh.p.k.**
- 38. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë banimi dhe shërbimesh 12, 15 dhe 17 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Fushë Krujë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Kegli-Duri” sh.p.k. dhe “Makaresh” sh.p.k.**
- 39. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt me përdorim të përzier, shërbime, hoteleri dhe banim me 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 kate mbi tokë, dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Selitë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Euro 3D” sh.p.k.**
- 40. Leje Ndërtimi për objektin: “Efi's Village” Struktura rezidenciale me 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë, 1 kat nëntokë, dhe strukturë hotelerie me 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë, 1 kat nëntokë, me vendndodhje në segmentin e ri të Rrugës Palasë-Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Xg Global Build” sh.p.k.**
- 41. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh “Kulla e Bardhë” me 24 kate mbitokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “RGR Group” sh.p.k dhe “2T” sh.p.k.**
- 42. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 1-9 kate + 1-2-3 kate nëntokë” me vendndodhje në Paskuqan, Bashkia Kamëz, me subjekt zhvillues shoqërinë “Golden Hands” sh.p.k.**
- 43. Leje Zhvillimi për objektin: “16 zona menaxhimi me funksione banim, shërbim, sport, hoteleri dhe përdorim i përzier, për “City of Parks”, me vendndodhje në Kodër-Kamëz, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana 2” sh.p.k.**
- 44. Leje Ndërtimi për objektin: “Hotel Iberostar, Resort me 5*, me 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë dhe me 1-5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Seaview Development” sh.p.k.**
- 45. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë me shërbime dhe banim 18 kate me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Ismail Qemali”, Bashkia Sarandë, dhe subjekt zhvillues shoqërinë “M.G.M Konstruksion” sh.p.k.**
- 46. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh me 1 dhe 27 kate mbitokë dhe me 1 deri 4 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë me subjekt zhvillues shoqërinë “Eisa” sh.p.k.**
- 47. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë me funksion hotel dhe rezidenca me 1, 6 dhe 8 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Borsh, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Diti Construction” sh.p.k.**

- 48. Leje Ndërtimi për objektin: “Vertigo Free Zone - Durres Industrial Park”, me vendndodhje në Xhafzotaj, Shijak, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vertigo” sh.p.k.**
- 49. Leje Zhvillimi për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh 17 kate me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “N94” sh.p.k.**
- 50. Leje Zhvillimi për objektin: “Objekt rezidencial dhe hoteleri me 33 kate mbi tokë dhe 4 kate nën tokë”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “DGC” sh.p.k.**
- 51. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt akomodimi- Guesthouse” me 1 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, me pishine dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Picallë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Z.Besmir Dervishi.**
- 52. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe hoteleri 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 kate, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Sh8”, Rradhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Sergio 1” sh.p.k.**
- 53. Leje Ndërtimi për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 15 kate me 4 kate parkime nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Dhimitër Kamarda”, Bashkia Tiranë, me subjeballakt zhvillues shoqërinë “Siera-Luis Construction” sh.p.k.**
- 54. Leje Ndërtimi për objektin: “Bar restorant dhe hotel 4 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me zhvillueViron Duni.**
- 55. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt apart-hotel dhe banim 12 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Yves Construction” sh.p.k.**
- 56. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë shërbimi dhe banimi 9-17 kate mbitokë, me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Xplorer” sh.p.k.**
- 57. Leje Ndërtimi për objektin: “Objekt banimi 15 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Egnatia”, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Dolça Building” sh.p.k dhe “Colombo” sh.p.k.**
- 58. Leje Ndërtimi për objektin: “Sunrise Towers 2”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Alb-Ontario Construction” sh.p.k.**
- 59. Leje Ndërtimi për objektin: “Banesë individuale 3 kat me 1 kat nëntoke me pishinë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Z. Gentian Lalaj.**
- 60. Leje Ndërtimi për objektin: “Tirana Gate”, zhvillim kompleks për ndërtimin r ambienteve të reja me funksion rezidencial dhe shërbimesh prej 1, 28 dhe 31 kate mbi tokë, me 3 kate nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues “Xh&M” sh.p.k, “Alfazed” sh.p.k dhe “Smart Construction Invest” sh.p.k.**

61. Leje Zhvillimi për objektin: “Banim dhe shërbime 12+1 kate, me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Myslym Shyri”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arb & Trans-2010” sh.p.k.
62. Leje Ndërtimi për objektin: “Strukturë turistike hoteleri dhe banim me 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 kate mbi tokë, me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën Butrinti, Bashkia Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Gentry Al Construction” sh.p.k.
63. Leje Ndërtimi për objektin: “The Terraces At Vlora”, hoteleri, shërbim dhe banim 3,7,10 dhe 13 kate mbi tokë dhe 2,3 dhe 4 kate nën tokë, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Baitel – Bojo Resort” sh.p.k.
64. Leje Ndërtimi për objektin: “AIRBP TIA projekti i zgjerimit”, me vendndodhje në Aeroportin “Nënë Tereza”, me vendndodhje në Bashkinë Krujë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Air Bp Albania” sh.p.k.
65. Leje për miratimin e ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Radhimë Fortress” - Kompleks turistik me 2 godina banimi 1-6 kate dhe 1 godinë akomoduese hoteleri 1-4 kate me 2 kat parkim nëntokë, me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Rever Investment And Development” sh.p.k.
66. Leje për shtyrje afati për objektin: “Kompleksi Turistik Thymus”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Chaonian” sh.p.k, shoqërinë “Drimadhe I & I” sh.p.k. dhe Z. Kostaq Duni.

Njoftim anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit mbi:

- **kërkesat për kontroll përputhshmërie të shqyrtuara nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit**, për periudhën 24.04.2026 deri më tani, sipas Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar.

Me respekt,

Adelajda ROKA

S e k r e t a r

Këshilli Kombëtar i Territorit

Annex F03-A8

Territorial Protection Inspectorate Statement

“Deklaratë e IKMT” - 12 May 2026

Document type: Official institutional statement

Addresses field verification, property No. 262/12 in cadastral zone 1007, Decision No. 5 and the reported existence of a preliminary EIA/VNM report.

Original Albanian-language statement follows.



DEKLARATË E IKMT

12/05/2026

Në përgjigje të interesimit të medias “Për verifikimin mbi punime të dyshuara në zonën e mbrojtur Pishë-Poro-Nartë”, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) sqaron:

Në vijim edhe të shqetësimeve të shprehura në publik, IKMT ka kryer verifikimet në terren në Pishë-Poro-Nartë. Nga ky verifikim është konstatuar se në Zonën Kadastrale 1007, në pasurinë Nr. 262/12 të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në emrin e personit juridik “Albania Land Development” po kryheshin punime rrethimi dhe punime përgatitore për rrugët e aksesit.

Këto punime rezulton se po kryhen në bazë të Vendimit Nr.5, datë 29.04.2026 “Për kryerjen e punimeve të rrethimit dhe të punimeve përgatitore në funksion të ndërtimit të rrugëve të aksesit brenda prone”, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Zvërnec South Adriatic Development” sh.p.k. Leja e sipër cituar është lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Ndërkohë, sipas njoftimit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit po vijon më tej me procedurat e lëshimit të Dokumentit të Lejes së Zhvillimit, në përmbushje të akteve nënligjore dhe në zbatim të ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Subjekti disponon dhe Raportin Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), “Zvërnec Peninsula – Kompleks Multifunksional, Banimi, Shërbimesh, Hotelerie, Rekreacion, Marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Kate”, me vendndodhje në Zvërnec, me Subjekt Zhvillues Shoqërinë Zvërnec South Adriatic Development Sh.P.K.

Për çdo leje të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, IKMT krijon grupe të përbashkëta inspektimi në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit me synim garantimin e ligjshmërisë në zbatimin e projekteve të miratuara.



Njoftimet e Fundit

- 

Deklaratë e IKMT

June 30, 2026
- 

Ndërhyrje mjedisore në Krujë, IKMT largon struktura ndotëse në Pyllin e Picrragës

June 25, 2026
- 

Ndërhyrje e IKMT në Shkodër për zbatimin e aksit “Kthesa e Bërdicës – Ura e Baçallëkut

June 22, 2026
- 

Lirohet territori për Parkun Natyror Ulëzë, IKMT ndërhyr në zonën e mbrojtur

June 19, 2026
- 

Vijon projekti i autostradës Tiranë–Durrës, IKMT ndërhyr në zonën e Kasharit

June 17, 2026

Informacione Kontakti

-  +355 69 70 28 105
-  Rruga Muhamet Gjollesha, pranë Inxhinierisë së Ndërtimit
- Orari i Punës:

 E hënë – E enjte: 8:00–16:30

E premte 8:00–14:00

Lidhje

-  [Rreth Nesh](#)
-  [Struktura](#)
-  [Njoftime](#)
-  [Aktivitete](#)
-  [Vende Vakante](#)

Lokacioni

Annex F06-B1

Environmental Declaration for the PDZRK “Vjosë-Nartë”

Planning-Level Strategic Environmental Assessment Record

Document type: Official planning-level
environmental declaration

This document concerns the VSM/SEA of the
territorial plan. It is not the project-specific EIA/VNM
for the 2026 development proposal.

Original Albanian-language document follows



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 860P/1 prot.

Tiranë, më 26.11.2021

DEKLARATË MJEDISORE
për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të nenit nr. 12 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

PLANI I DETAJUAR I ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE
"VJOSË-NARTË"

Kufijtë e zonës që mbulon Planin: Zona në studim shtrihet në veri të qytetit të Vlorës dhe bën pjesë në peizazhin e mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë, Zonë e Mbrojtur e Rëndësisë Kombëtare.

Autoriteti propozues: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimin:

Planin në tërësi, si dhe të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor, duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, si dhe duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore.

Përputhja e planit të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin mjedisor:

Planin i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe plotëson kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, si ai për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura, për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave, menaxhimin e integruar të mbetjeve, menaxhimin e zhurmës në mjedis, ndryshimet klimatike, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave etj. Qëllimi i këtij plani si dhe objektivat e tij kanë marrë parasysh dhe kanë integruar përputhshmërinë me disa plane apo programe themelore sikurse me Strategjinë Sektoriale Kombëtare për Transportin 2015-2020, Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe atë Vendor,

Strategjinë Kombëtare të Biodiversitetit, Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit, Strategjinë Kombëtare Për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, etj.

Në kuadër të këtij vlerësimi mjedisor u identifikuan ndikimet negative dhe pozitive, dhe u komentuan mundësitë e shfaqjes së ndikimeve, shkalla e tyre, shpeshtësia e shfaqjes së tyre dhe kohëzgjatja, kthyeshmëria, karakteri i tyre ndërkufitar, karakteri i tyre kumulativ ose synergjik etj.

Që vizioni dhe objektivat e zhvillimit të realizohen janë evidentuar projekte sipas tre drejtimeve kryesore:

1. Përmirësimi i aspekteve mjedisore
2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e zonave dhe
3. Zhvillimi i turizmit

Këto projekte klasifikohen dhe në bazë të impaktit që kanë:

- Projekte pa të cilat zona nuk mund të funksionojë si zonë turistike dhe
- Projekte që lidhen me funksionimin e përditshëm të zonës.

Disa projekte janë madhore dhe lidhen me politikat kombëtare, të tjera janë projektet e vetë zhvillimit të zonës. Projekte të tjera do të shtohen në fazën e detajimit të planit, por këto projekte do të jenë të lidhura vetëm me funksionimin e zonës në brendësi të saj.

Objektivat strategjikë mjedisorë

Bazuar në analizën e detyrimeve të specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë, situatës ekzistuese të mjedisit, dhe ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan, Raporti i VSM-së përcakton komponentët më të rëndësishëm mjedisorë dhe objektivat mjedisorë si me poshtë:

- Toka
Objektivi mjedisor 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.
Objektivi mjedisor 2: Ruajtja e mjedisit fizik dhe tërësisë së elementëve natyrorë të zonës nga erozioni/sedimentim.
- Ajri
Objektivi mjedisor 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasinë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.
- Faktorët klimatikë
Objektivi mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.
- Uji
Objektivi mjedisor 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.
- Mjedisi natyror
Objektivi mjedisor 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.



Objektivi mjedisor 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme. Ruajtja e biodiversitetit dhe zhvillim i integruar i ekoturizmit në harmoni me zonimin e zonës së peizazhit të mbrojtur

Mbetjet

Objektivi mjedisor 8: Zhvillimi dhe aplikimi i skemës së menaxhimit të mbetjeve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

- Zhurmat

Objektivi mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE-ja dhe OBSH-ja.

- Popullsia dhe Ekonomia lokale

Objektivi mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe levizshmërisë së qëndrueshme.

- Trashëgimia kulturore

Objektivi mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonës dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

- Peisazhi

Objektivi mjedisor 12: Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Arsyetimi se si janë marrë në konsideratë mendimet e publikut për pasojat në mjedis të Planit të propozuar:

Në takimet e organizuara me publikun dhe palët e përfshira në procesin e VSM-së dhe vetë dokumentin e PDZRK Vjosë-Nartë, ka rezultuar se ky plan është pritur me pozitivitet nga komuniteti dhe grupet e interesit.

Përveç përfshirjes së institucioneve në nivel qendror, që janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe për sektorin e planifikimit të territorit, janë përfshirë edhe institucionet për zbatimin e politikave për sektorin e menaxhimit të ujrave, mbetjeve, si dhe ato të planifikimit të transportit. Pjesë e rëndësishme e procesit të konsultimit kanë qenë edhe përfaqësues të stafit të bashkisë, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura përfaqësues biznesesh, përfaqësues të organizatave joqeveritare, ekspertë të fushave të ndryshme, etj.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e PDZRK Vjosë-Nartë pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatëse.

Rëndësi të veçantë i jepet mbrojtjes së mjedisit meqënëse kjo zonë njihet për brezin e pishave si dhe dunat ranore. Qëllimi i projektit është, zgjerimi i ofertës turistike, kohëzgjatjes së sezonit dhe frekuentimit të tij, si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për të arritur konkurrencën në tregun e turizmit me vendet fqinje. Komentet e grupeve të interesit janë marrë parasysh kryesisht në përcaktimin e masave zbutëse për zbatimin e planit.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten ndikime të mundshme mjedisore, sociale edhe ekonomike.

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, ajrore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohë zhvillimet e projekteve të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, tokë, ujë, etj.).

Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur) dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

Ndikimet pozitive priten në promovimin e zhvillimit të aktiviteteve turistike, në përshtatje të zonave me vlerë natyrore, por njëkohësisht në mënyrë miqësore me mjedisin duke ruajtur veçoritë dhe habitatet natyrore.

Zhvillimi i turizmit natyror sipas parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, do të sjellë rritje të vlerës së shtuar të potencialeve turistike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Masat zbutëse që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efiçente në përdorimin e energjisë, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri, po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Plani duhet të nxisë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihen zhvillimi i aktiviteteve dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyror, duke respektuar kriteret dhe specifikimet e Ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, Ligjit nr. 10 0006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni dhe në përputhje me kushtet e ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit, duhet të përfshihen masa që do të mundësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore, sidomos në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zona të mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.

Promovimi brenda dhe në periferitë e zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.

- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelbërta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të kenë objektiva të matshme për cilësinë e ajrit.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmbytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmbytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmbytjeve).
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.
- Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.

Kërkesat për monitorimin mjedisor raportimin periodik në ministri gjatë zbatimit të Planit:

- Nëse plani nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e vet-qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tij dhe nuk respekton kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëherë ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimin e planit dhe sipas rrethanave dhe i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.
- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të Planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky program të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të Planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të këtij Plani.

Kërkesa për raportim mjedisor periodik

- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standartet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masa e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standartet mjedisore.



Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore.

- Autoriteti përgjegjës, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e PDZKR Vjosë-Nartë, duhet të hartojë periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta depozitojë pranë Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin, jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

MINISTËR

Mirela KUMBARO TURXHI

